




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-22774/24 datë: 22.08.2024



Npi – 01/293 datë: 28.08.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 28.08.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 28.08.2024 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtori i DPUKGJ-së z.Grejtalb Emini, Drejtori i DBF-së z.Besnik Ahmeti, Asistentrja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti, dhe nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 02.07.2024,
2. Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023,
3. Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023,
4. Raporti buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024,
5. Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (për diskutim publik),
6. Propozim-Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 dt.06.09.2012, për dhënjën në shfrytëzim sipërfaqen prej 50 ari truall, Policisë së Kosovës njësia në Shtime,
7. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emertimin e Objekteve Publike,
8. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emerimin e Rrugeve dhe Shesheve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetj, pajtohem me rendin e ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 02.07.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.08.2024.

Pika 2

Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje, meqenëse materialin për këtë pikë e keni pranuar në formë të shkruar. (shih dokumentin) unë do të ndalem vetëm në pikat kryesore. Opinioni i ZKA-së është i kualifikuar, i cili është bazuar në 3 pika. Në vazhdim i sharoj këto tri pika që i ka dhënë Auditori. Rekomandime janë gjithësej 8 prej tyre 3 janë të reja e 5 rekomandime të vjetra, Nëse ka dikush ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, e kemi lexuar raportin, dhe unë kamë ardhur në përfundim se Kryetari duhet me e rritë kontrollin e brendshëm të drejtorive sepse duhet të zbatohen disa kontrata dhe rekomandime në përpikmëri. Rekomandimet e Auditorit duhet me i eliminuar dhe mos me pas më rekomandime të reja , dhe mos të përsëriten prap të njejtat rekomandime. Rekomandimet kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm, prandaj duhet me kërku përgjegjësi nga drejtorët. Uroj që në të ardhmen të ketë sa më pak rekomandime ose mos të ketë fare.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për elaborimin e raportit të Auditorit. Vet tituli po tregon se ka të gjetura, dhe është opinion i kualifikuar. Duhet me pranë se puna e ekzekutivit është e keqe sepse kemi një opinion të tillë nga një organ i pavarur. Ju e keni ditë për obligimet kontigjente nga kontrata kolektive. Pajtohem me Kadriun se kontrolli ndaj drejtorive duhet shtuar.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; E thash që nuk kemi rekomandime të rënda të cilat mund të kishin përfunduar në hetuesi. Obligimet kontigjente janë si pasojë e veprimeve të mëhershme që kanë qenë fare pa mbules financiare, tania to gabime po na kushtojnë neve për ti përmbushur sot, dhe ne tash nuk mund ta dimë se sa kërkesa mund të jetnë paraqitur në gjykata. Në tërsi raporti është i mire, sepse ka vetem 3 rekomandime, jemi njerëz dhe mundemi me gabu dikund, prandaj edhe po bëjmë përpjekje që me i eliminuar.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit të auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023.**

Pika 3

Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Edhe për këtë pikë materialin e keni pranuar me kohë në formë të shkruar. (shih dokumentin). Në vazhdim i sharoj pikat kryesore të Planit të Veprimit. Kemi tri pika kryesor të rekomandimeve të cilat duhet të eliminohen duke u bazuar në këtë plan që e ka hartuar grupi i punës i formuar nga Kryetari i Komunës. Një rast është në sektorin e bujqësisë. Një rast tjetër është te biznesi "STN" që ka të bëjë me një barnatore. Dhe rasti i tretë është te menaxhimi i kontratave te drejtoria e prokurimit që nuk i kanë futë në databazën elektronike të prokurimit. Një pikë tjetër është te obligimet tatimore, e që realisht kjo ka të bëjë me pronarët që shumica janë të komunitetit serb, por ka edhe shqiptar që janë nëpër gjykata. Nëse ka dikush ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Në shtatë raste ka thanë Auditori se ka pagesa jo adekuate. Pyetja ime është pse keni lejuar që të ndodhë një gjë e tillë?

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, me e shikuar detaisht ne kemi punë me drejtorat, dhe këta duhet me na dhënë neve përgjigje për shpenzimet e kryera, pra ne kemi punë me drejtorat e dikastereve konkrete, sepse ata e dine për qka i kanë kërkuar mjetet dhe si e sa i kanë shpenzuar ato.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Kur e kemi bërë planin e veprimit kanë qenë present të gjithë drejtorat.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje, për deri sa Auditori nuk ka gjetur asnjë rekomandim të shkeljes ligjore, raporti nuk është i keq, po ashtu edhe për faktin se i kemi vetëm 3 rekomandime të reja. Uroj që në të ardhmen mos të ketë asnjë rekomandim, dhe këto që janë të eliminohen.

z.Përparim Ramusa; Zejnije, nuk mundesh me thane se nuk ka pas shkelje ligjore, sepse i kemi 3 rekomandime të reja.

*** Nuk ka rekomandim.**

Pika 4

Raporti buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Bazuar në nenin 45.4 të Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne jemi të obliguar që ta prezantojmë raportin buxhetor periodik, në këtë rast për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2024. Edhe për këtë pikë materialin e keni pranuar me kohë në formë të shkruar. (shih dokumentin). Realizimi i buxhetit për këtë periudhë i shprehur në përqindje është 45.43 %. Në vazhdim drejtori i spjegoi shpenzimet sipas kategorive ekonomike veç e veç me shifra, duke u bazuar në raport. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit aprovimin e raportit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit Buxhetor të Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024.**

Pika 5

Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse Draft-Buxheti duhet të shkojë në diskutim publik, propozoj që direkt t’i rekomandojmë Kuvendit miratimin e kësaj pike.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ta dërguar në diskutim publik Draft-Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 6

Propozim-Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 dt.06.09.2012, për dhënjën në shfrytëzim sipërfaqen prej 50 ari truall, Policisë së Kosovës njësia në Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, materialin për këtë pike e keni marrë, dhe e keni parë se këtu e kemi një vendim të Kuvendit të vitit 2012 me të cilin ju ka nda 50 ari oborr Policisë së Kosovës njësia në Shtime për me ndërtuar objektin e Policisë. Siç e dini tash më të gjithë se Policia është dislokuar me një objekt të ri në rrugën “Tahir Sinani” afër Entit Special dhe tash më ajo parcelë është e lirë sepse në të nuk është bërë asnjë lloj ndërtimi, dhe tani më ajo nuk ka nevojë të mbetet e bllokuar, sepse në atë vend ka mundësi që të kemi një projekt të mire për ndërtimin e banesave kolektive sipas premtimit për banim të përballeshëm.

z.Përparim Ramusa; Caktimi se kjo pronë ka me shkuar për banim kolektiv është i qëlluar, mirëpo duhet me pas parasysh edhe faktin se mos kanë Policia ndonjë plan për atë prone, prandaj der isa ti sigurojmë këto informata ne do të “Abstenojmë” këtu deri në mbledhjen e Kuvendit ku do të debatojmë më gjerësisht.

znj.Zejnije Veliu; Unë po habitem se si Kuvendi ja ka dhënë atë prone Policisë kur dihet se ku e kemi tani Policinë në një vend krejt tjetër.

znj.Adelina Beqaj; Me sa e di unë e kemi një plan të veprimit për banim të përballeshëm që e ka miratuar Kuvendi. Pyetja ime është se a e keni konsultuar këtë Plan veprimi për me qenë të harmonizuara të gjitha veprimet?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Për projektin e banimit të përballeshëm në komunën tonë ende nuk kemi një informacion të saktë. Por mund të them se kërkesat janë që zona e projektit për banim të përballeshëm duhet të jetë sa më afër qendrës urbane për shkak të shumë factorëve. Sipas numrit të banorëve komunës tone i takojnë afërsisht 78 njësi banesore, gjysa për banim social.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për anulimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 dt.06.09.2012, për dhënjën në shfrytëzim sipërfaqen prej 50 ari truall, Policisë së Kosovës njësia në Shtime.**

Pika 7

Propozim-Vendim per formimin e komisionit per emertimin e Objekteve Publike

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nese jeni të pajtimt ne i kishim rekomanduar Kuvendit direkt për formimin e këtijë Komisioni, sipas qelësit të propozuar prej 7 anëtarëve, ndërsa emrat i vendosim në Kuvend.

z.Përparim Ramusa; Unë propozoj që në Komision të jetë edhe një përfaqësues i organizatave të dala nga lufta e UÇK-së.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit per formimin e komisionit per emërtimin e Objekteve Publike.**

Pika 8

Propozim-Vendim per formimin e komisionit per emerimin e Rugeve dhe Shesheve

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe në këtë pike e kemi shtatëen e njëjtë për formimin e komisionit prandaj propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit për formimin e komisionit sipëas qelësit të njëjt prej 7 anëtarëve dhe emrat e anëtarëve ti zgjedhim në Kuvend.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit per formimin e komisionit per emërtimin e Rugeve dhe Shesheve.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:22h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

